



Mijëra pensionistë dhe pensioniste prej dhjetë shoqatave të Maqedonisë dhe mysafirë nga shoqata simotra nga Vranja, Serbi, erdhën për tu relaksuar, shoqëruar, ndërsa disa edhe për të vizituar qendrën përkujtimore ASNOM

Takimet dhe mbledhjet e pensionistëve janë një prej formave më të dashura të shoqërimit të të gjithë pensionistëve - anëtarë të LSHPM. Në këto takime ata shoqërohen, krijojnë miqësi të reja, relaksohen dhe zbukurojnë ditët e tyre të pensionistit. Krahas asaj, në takime mbahen edhe mbledhje pune në të cilat këmbëhen përvoja dhe kërkohen zgjidhje për probleme të përbashkëta të caktuara. Edhe një anë e bukur e këtyre shoqërimeve është që në këto takime pensionistët njihen edhe me bukuritë e atdheut tonë dhe trajtohet bashkëjetesa dhe jeta në bashkësi. Ashtu është çdoherë. Ashtu ishte në takimet e këtyra, me rastin e jubileut të madh të pensionistëve në Oreovicë, Vinicë, Pelincë, Bogomillë, Pantelej dhe vende të tjera. Takim i bukur dhe masovik u mbajt më 24 korrik në Oreovicë, në oborrin e kompleksit të manastirit "Shën Gjorgjia", në afërsi të Radovishit. Në këtë lokalitet tërheqës, u mbajt takim madhështor ku u shoqëruan mbi 9000 pensionistë nga një numër i madh i shoqatave anëtare të LSHPM. Në fillim mysafirët i përshëndeti kryetarja e Aktivit të pensionistëve Pavlina Çabukova, ndërsa pas asaj

Takimet masovike të pensionistëve me rastin e jubileut të madh

## Bashkë për relaksim



### EKSKURSION NJËDITOR NË POGRADEC

Në pajtim me Programin për punë, Shoqata e pensionistëve Gostivar, më 9 korrik 2016 me qindra anëtarët e saj ka realizuar ekskursionin e planifikuar jashtë vendit. Pensionistët e Gostivarit me 2 autobusë u nisën drejt destinacionit të theksuar, qytetës turistike Pogradec të Shqipërisë. Gjatë rrugës, në Strugë u ndalën dhe bënë një pauzë të shkurtë, sa për të shtrirë këmbët dhe të lëvizin pak. Pastaj, përmes vendkalimit Qafëthanë rruga i ka bartur përreth Liqenit të Ohrit nga ana shqiptare, ku shumica për herë të parë kanë patur rastin të kalojnë nëpër zonë përreth liqenit dhe të mahnitën me bukuritë dhe shkëlqimin e natyrës që e ka krijuar dhe ruajtur. Duke shijuar pamjen e bukur, thuajse pa vërejtur arritën në Pogradec, ku, kryetari i shoqatës Nijazi Xhelili i njoftoi me planin për shëtitje nëpër qytet dhe vizitë të vendeve të rëndësishme me të cilat disponon ky vend turistik. Pensionistët kurioz shëtitën nëpër rrugët e bukura, përreth plazhit dhe tregut, ku me të vërtet kishte se çka të shihet, të zgjidhet dhe të blihet si përkujtim gjatë këtij udhëtimit.

kryetari i shoqatës Jordan Kostadinov, në fjalimin e tij të rastit u dëshiroi mirëseardhje dhe theksoi se në këtë vend, mbahen shoqërime me masovike të pensionistëve në vend. Në takim mori pjesë kryetari i Komunës Radovish Sashko Nikollov, i cili shprehu kënaqësinë e madhe dhe u shpreh me fjalë miradije për organizatorin e takimit. Shumë impresionues ishte fjalimi i

kryetarit të LSHPM-së, Dragi Argirovski, i cili duke i përshëndetur të pranishmit theksoi se ky takim numërohet në radhën e manifestimeve dhe takimeve të pensionistëve që sivjet organizohen me rastin e jubileut të madh, 70 vjet nga organizimi i pensionistëve në R. Maqedonisë dhe tha se qëllimet e këtyre takimeve janë përmblusur. Ato janë masovike, ndërsa aty pen-

sionistët shoqërohen, argëtohen dhe këmbëjnë përvoja. Pastaj ai shpalli takimin të hapur. Takim në të cilin morën pjesë rreth 700 pensionistë nga shumë shoqata u mbajt në Vinicë, me rastin e festës "Java e Tomit". Në takim mirëseardhje u dëshiroi kryetari i SHP Vinicë, Dragan Petkovski, ndërsa në emër të LSHPM foli për jubileun e madh të pensionistëve, Stanka Trajkova,

sekretare e KE të Lidhjes. Më 2 gusht, në festën e Ilindnit, në Bogomillë, Komuna Çashkë, u lëshua në përdorim Shtëpia e rinovuar rekreative për pensionistët dhe të rinjtë. I pari mysafirëve ju drejtua kryetari i SHP Veles, D-r Vele Aleksoski i cili tha se shtëpia ka dhjetëra dhoma me nga 3-4 krevate dhe sallë sportive për shumë aktivitete, si dhe fushë sportive për futboll të madh. Të pranishmit i përshëndeti edhe Goranço Panovski kryetar i komunës Çashka, i cili shprehu kënaqësinë për hapjen e Shtëpisë rekreative për pensionistë dhe të rinj. Duke përshëndetur takimin kryetari i LSHPM, Dragi Argirovski theksoi se kjo është shtëpia e dytë e këtij lloji në Maqedoni, pas asaj në Shkup, e cila krahas që është për rekreacion lehtë mund të adoptohet në Shtëpi për qëndrim të të moshuarve dhe personave të paafatë. Në ambientin e bukur të kompleksit veror dhe turistik në Pelincë, në organizim të SHP Kumanovë, u mbajt takimi i 15-të me radhë tradicional, ndërkombehtar, multietnik i pensionistëve "Ekohepening Pelince 2016". Mijëra pensionistë dhe pensioniste prej dhjetë shoqatave të Maqedonisë dhe mysafirë nga shoqata simotra nga Vranja, Serbi, erdhën për tu relaksuar, shoqëruar, ndërsa disa edhe për të vizituar qendrën përkujtimore ASNOM. Në takim fjalim për-

shëndetës mbajti kryetari i SHP Kumanovë, Spirko Nikollovski, ndërsa në emër të Komunës Nagorican i Vjetër të pranishmëve ju drejtua kryetari Millovan Stojkovski. Në takim morën pjesë dhe përfaqësues nga LSHPM, kryetari i Kuvendit të LSH-PM, Besnik Pocesta dhe kryetari i KE, Stanka Trajkova, të cilët vlerësuan takimin si jashtëzakonisht të suksesshëm. Të pranishmëve ju drejtua edhe kryetarja e pensionistëve nga Vranja, Mira Trajkoviq, si dhe kryetari i KE të SHP Solidarnost - Aerodrom, Dimitrije Bogatinovski. Në kompleksin e manastirit "Sv. Pantelejon" në fshatin Pantelej të Koçanit, më 11 gusht u mbajt takimi i 11-të i pensionistëve të Maqedonisë, në të cilin morën pjesë mbi 2000 pensionistë nga 25 shoqata të pensionistëve nga Maqedonia. Organizator i takimit ishte SHP Koçan. Para të pranishmëve fjalim përshëndetës kishte kryetari i SHP Pelincë, në organizim të SHP Kumanovë, u mbajt takimi i 15-të me radhë tradicional, ndërkombehtar, multietnik i pensionistëve "Ekohepening Pelince 2016". Mijëra pensionistë dhe pensioniste prej dhjetë shoqatave të Maqedonisë dhe mysafirë nga shoqata simotra nga Vranja, Serbi, erdhën për tu relaksuar, shoqëruar, ndërsa disa edhe për të vizituar qendrën përkujtimore ASNOM. Në takim fjalim për-

Finaliohet shënimi i denjë i jubileut

## Gati për 70-vjetorin e organizimit të pensionistëve

Më 18 shkurt të këtij viti, në mbledhjen e gjashtë të zgjeruar - Këshilli ekzekutiv i LSH-PM-së miratoi Konkluzione për shënimin e 70 vjetorit të organizimit të pensionistëve në Maqedoni. Pjesa më e madhe e tyre tash më janë realizuar me sukses. Këshilli organizativ për shënimin e jubileut, të cilin e përbëjnë 39 aktivistë të dalluar, më 18 mars mbajtën mbledhje në të cilën u bisedua për rëndësinë e jubileut dhe pastaj u formua me shumë komisione. U mbështet edhe propozimi me rastin që në këtë eveniment LSHPM të votojë Monografi, si dhe librat "Studimi i organizimit të pensionistëve" dhe "Argumentet ndriçojnë të vërtetën". Konkluzionet e propozuara nga Këshilli ekzekutiv në tërësi ishin të miratuara. Për kënaqësinë tonë, kryetari i Maqedonisë, Gjorge Ivanov pranoi propozimin që të

mbulojë dhe të mbajë fjalim në Akademinë solemne, e cila do të mbahet më 16 shtator, në ora 11, në sallën e madhe të Shtëpisë së Armatës me rastin e jubileut tonë të madh dhe të rëndësishëm. Në solemnitet, për historinë dhe zhvillimin e LSH-PM do të flasë kryetari Dragi Argirovski. Do të intonohet himni dhe do të shfaqet një program kulturo-artistik prej 30 minutave me pjesëmarrjen e ansambleve të SHP Gazi Babë, Solidarnost - Aerodrom, Çair dhe Gjorçe Petrov. Me rastin e jubileut, besojmë se kryetari i shtetit do të pasqyrojë LSHPM me mirënjohje të lartë, me çka do tu bëjë nder dhe respekt 250.000 pensionistëve të vendit tonë. Sa i përket mirënjohjeve që do tu ndahen institucioneve me të cilat LSHPM për një kohë të gjatë ka patur bashkëpunim të suksesshëm, mysafirëve nga



jashtë vendit, kryetarëve të komunave, shoqatave, aktivistëve tanë të theksuar, shoqërive kulturore, sportistëve dhe të tjerëve, në bazë të kriterëve të sjellja që janë sjellë deri tek shoqatat e pensionistëve dhe priten propozimet e tyre. Është propozuar që të ndahen 140 mirënjohje, pllaketa dhe falënderime. Të gjithë fituesit e mirënjohjeve si dhuratë do të marrin edhe librin "Argumentet ndriçojnë të

vërtetën", ndërsa 54 shoqatave të pensionistëve - anëtare të LSHPM edhe librin "Studim për organizimin të pensionistëve". Redaksia për Monografinë me rastin e 70 vjetorit të organizimit të pensionistëve në Maqedoni, gjithashtu ka mbajtur mbledhje në të cilën përcaktoi temat dhe de-tyrat. Që të përfshijë evenimentet në këtë vit jubilar Monografia duhet të përpilohet dhe publikohet

në muajt e parë të vitit të ardhshëm. Mes tjerash, do të caktohet tirazhi sipas mundësive financiare, ndërsa libri do të botohet në gjuhën maqedonase, shqipe dhe angleze. Në botim të LSHPM në muajin qershor nga shtypi doli libri "Studimi për organizimin e pensionistëve" nga Ilija Gligorov dhe Dragi Argirovski, promovimi i të cilit u mbajt më 16 qershor 2016, ndërsa për veprën fjalën kishte D-r Zhivko Mitrevski, kryetar i LSM. Nga shtypi doli edhe libri i 20-të publicistik "Argumentet ndriçojnë të vërtetën" nga Dragi Argirovski, i cili në mënyrë solemne do të promovohet më 26 gusht, në ora 12, në sallën e madhe të LSM. Me rëndësi është që në vitin e jubileut LSHPM u shpërndan në hapësirat e reja moderne, të cilat i përdorë pa kompensim. Për shkak të krizës politike në Republikën e

Maqedonisë, dështoi mbajtja e "Revysë ballkanike të këngëve" ndërkombehtarë që u përpoqem sivjet të mbahet në Shkup. Megjithatë, për shkak të njohura mbështetja financiare nga Bashkimi evropian u vonua. Manifestimet dhe takimet e pensionistëve gjatë vitit 2016 kanë kaluar në frymën e jubileut 7 dekadësh të LSHPM. Për rëndësinë e jubileut është folur në tetë revyë të rajonale dhe në revynë republikane të këngëve, muzikës dhe valleve, që është shpallur si më e mira deri tani, dhe ashtu ishte edhe në tetë garat sportive rajonale, që do të realizohet edhe më 3 shtator në garat e 21-ta sportive republikane që do të mbahen në Radovish. Në frymën e jubileut të suksesshëm kanë dalë edhe të gjitha piknik - takimet, si dhe të gjitha takimet e tjera të pensionistëve në vendin tonë.